



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 07.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **01.08.2025**, të parashtruar nga **Tech Vision shpk** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Zhvillimi i Modulit të TMJISHP"** me nr. prokurimi 206-25-4491-2-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE Tech Vision shpk e dt. 01.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Zhvillimi i Modulit të TMJISHP"** me nr. prokurimi 206-25-4491-2-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 28.07.2025;
2. **Anullohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 28.07.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në rivlerësim aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE Tech Vision shpk me datën 01.08.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Zhvillimi i Modulit të TMJISHP"** me nr. prokurimi 206-25-4491-2-1-1. Autoriteti Kontraktues me datën 07.08.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

- **Neni 1** i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (mosrespektimi i qëllimit të ligjit për përdorim transparent dhe konkurrencë të ndershme)
- **Neni 7** i LPP-së (parimi i transparencës dhe trajtimit të barabartë)
- **Neni 59** i LPP-së (mosvlerësimi i drejtë i ofertave sipas kriterëve të përcaktuara)
- **Neni 65** i LPP-së (verifikimi i dokumenteve të ofertuesve)
- **Neni 10** i Udhëzuesit Nr. 002/2024, faqe 40 (sqarimi i dokumenteve gjatë vlerësimit)

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik TreTek, ndonëse ky i fundit **nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të verifikueshme** për kontrata të mëparshme të zhvilluara në teknologji Microsoft ASP.NET me SQL Server, siç kërkohet në FDT. Konkretisht, operatori ka dorëzuar **referenca të përgjithshme** pa përshkrime teknike, dhe pa dokumente të nënshkruara nga blerës privatë që dëshmojnë realizimin dhe vlerën e kontratave.

Kërkesa 1 (nga dosja e tenderit) citojmë:

"Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses, gjatë tri viteve të fundit, kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë totale 195,000 euro, ku në mesin e tyre të dëshmojë të paktën një kontratë me web aplikacion të zhvilluar në teknologjinë Microsoft, ASP.NET me bazë të dhënash SQL."

Dëshmia 1:

"Listën e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha shërbimet e kryera të realizuara në tri vitet e fundit. Listës duhet t'i bashkëngjiten:

b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i realizimit të tillë. Çdo dokument duhet të ketë të shënuar vlerën e realizimit të shërbimeve."

TreTek ka dorëzuar vetëm referenca të përgjithshme, pa përshkrime teknike që provojnë përdorimin e teknologjive të kërkuara dhe pa dokumente të nënshkruara nga blerës private që dëshmojnë realizimin dhe vlerën e kontratave. Në mungesë të kësaj dëshmie, referencat e paraqitura nuk mund të konsiderohen të verifikueshme dhe për rrjedhojë nuk plotësojnë kërkesën thelbësore për kontratë të ngjashme të realizuar në teknologjinë Microsoft ASP.NET dhe SQL Server. Sipas nenit 59 të LPP-së, vetëm ofertat që përmbushin tërësisht kriteret teknike duhet të merren në shqyrtim.

Gjithashtu, operatori ekonomik i shpërblyer nuk ka përmbushur:

Kërkesën 2, pika e.2 (nga dosja e tenderit) citojmë:

"Dy (2) Zhvillues të Softuerit (Programer) - Bachelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Bachelor i shkencave kompjuterike, me përvojë pune minimum 3 vjeçare pas diplomimit, në zhvillimin e softuerit të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)."

"Dëshmia: Kopje e diplomës, CV e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt."

Operatori ekonomik TreTek ka propozuar si njërin nga zhvilluesit z. **Vegim Karaçica**, duke dorëzuar një **kontratë pune**, në të cilën ai figuron si **zhvillues softuerik që nga viti 2021**.

Por, për të njëjtën periudhë kohore, është dorëzuar edhe një **referencë tjetër zyrtare** nga e njëjta kompani, ku specifikohet qartë se z. Karaçica ka qenë i angazhuar në cilësinë e **Arkitektit të Softuerit**.

Ky mospërputhje e hapur midis kontratës dhe referencës krijon **dy të dhëna të kundërta për të njëjtën periudhë kohore**, duke e bërë të pamundur verifikimin real të përvojës relevante si zhvillues softuerik në teknologjinë Microsoft .NET me SQL Server, siç kërkohet në FDT.

Kjo nënkupton se operatori ekonomik ka **dëshmuar vetëm një zhvillues softuerik**, nga **dy sa kërkoheshin**, dhe për rrjedhojë ka **dështuar të përmbushë kushtin thelbësor teknik për kualifikim**.

Për më tepër, në rastin e z. Karaçica, CV-ja dhe kontrata e punës nuk janë të nënshkruara nga vetë inxhinieri, siç kërkohet qartë në dokumentacionin e tenderit.

Nënshkrimi është paraqitur në formë elektronike, të imituar në stil italic, që nuk përfaqëson një nënshkrim autentik dhe të vlefshëm të bërë nga vetë personi i angazhuar për pozitën në fjalë. Si rrjedhojë, dokumenti i dorëzuar nuk mund të konsiderohet si dëshmi e vlefshme për përmbushjen e kriterit që kërkon CV të nënshkruar nga eksperti.

Ky veprim paraqet **devijim të qëllimshëm**, përmes paraqitjes së të dhënave kontradiktore dhe të paplotësuar, me qëllim për të mashtruar Autoritetin Kontraktues dhe për të përfituar padrejtësisht nga procedura. Kjo bie ndesh me **nenet 59 dhe 65 të LPP-së**, si dhe me **nenin 10 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik** (faqe 40), i cili ndalon qartë legalizimin e dokumenteve të papërputhshme përmes sqarimeve të mëvonshme.

Bazuar në **nenin 10 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik (faqe 40)**:

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 *Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së*

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Ky nen nuk lejon sqarime për dokumente që nuk përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit. Në mënyrë specifike, sipas pikës 10.1 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik dhe në përputhje me nenin 69 të LPP-së, kur CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat, Autoriteti Kontraktues është **i obliguar të refuzojë tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme**. Kjo dispozitë eliminon çdo mundësi të legalizimit të dokumenteve të paplota apo joautentike nëpërmjet sqarimeve të mëvonshme gjatë vlerësimit.

Bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, shpërblimi i kontratës në favor të operatorit ekonomik TreTek është bërë në kundërshtim të hapur me:

- **Kriteret teknike të përcaktuara qartë në dosjen e tenderit**, të cilat nuk janë përmbushur nga operatori i shpërblyer;
- **Dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës**, veçanërisht nenet 1, 59, 65 dhe 69 që rregullojnë trajtimin e ofertave të papërputhshme;
- **Udhëzuesin zyrtar për zbatimin e prokurimit publik**, përfshirë nenin 10 (faqe 40) që ndalon kërkimin e sqarimeve për dokumente që nuk përmbushin kërkesat thelbësore.

Në këto rrethana, kërkojmë që të anulohet vendimi për dhënien e kontratës dhe të ndërmerret rivlerësimi i ofertave në mënyrë të drejtë, objektive dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit.

8. Dëmet materiale

Shpenzimet mbi angazhimin në përgatitjen e ofertës, sigurimi i ofertës, koha e humbur, ngakesa dhe stresi, fitimi i humbur .

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim te derguar nga Tech Vision shpk në kete procedurë dhe konsiderojme se pretendimet ankimore jane te bazuara.

Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar Tretek SH.P.K. ka dorëzuar vetëm referenca të përgjithshme, pa përshkrime teknike që provojnë përdorimin e teknologjive të kërkuara dhe pa dokumente të nënshkruara nga blerës privatë që dëshmojnë realizimin dhe vlerën e kontratave, konsiderojme se ky pretendim eshte pjeserisht i bazuar, meqense disa nga referencat e prezantuar e kane vleren e kontratave ndersa disa jo. Gjithashtu gjate rivleresimit duhet te vertetohet edhe pretendimi se kontratat e realizuara nga OE TreTek jane pa përshkrime teknike që provojnë përdorimin e teknologjive të kërkuara.

Sa i perket pretendimit se ne oferten e OE te rekomanduar Tretek SH.P.K. eshte ofruar si Zhvillues i Softuerit z. Karaçica, qe CV-ja dhe kontrata e tije e punës nuk janë të nënshkruara nga vetë inxhinieri, siç kërkohet qartë në dokumentacionin e tenderit, konsiderojme se ky pretendim eshte i bazuar dhe lehtesisht i vertetueshem ne oferten e OE te rekomanduar Tretek SH.P.K.

Ne baze te pretendimeve dhe sqarimeve te lartcekura, AK-MSh vendos qe ky aktivitet te kthehet ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit